



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në seancën së 87-të, të mbajtur më 01.06.2023, morri vendimin vijues:

VENDIM

Procedura në lëndën nr.12-165/1 datë 12.01.2021, e formuar pas denoncimit për dyshimin e keqpërdorimit të pozitës zyrtare dhe punës nga pakujdesia në shërbim nga drejtori i ISHP-së -----, NDËRPRITET.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, KSHPK ka konstatuar se nuk ka elemente për veprime të mëtejshme, për faktin se tashmë ka vepruar dhe ka marrë vendim për rastet me pretendime të njëjta.

Lënda me numër 12-165/1 të datës 12.01.2021 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Inspektorati Administrativ Shtetëror më datë 12.01.2021, ka dorëzuar kallëzim për veprime kompetente, ku dyshohet për keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe punë të pakujdesshme në shërbim nga drejtori i ISHP-së ----- dhe është formuar lënda me numër 12-165/1 datë 12 janar 2021.

Në denoncimin e dorëzuar ndaj personit zyrtar të cekur janë paraqitur këto pretendime: nga institucioni shëndetësor privat është emëruar ushtrues detyre i drejtorit të institucionit shëndetësor; si ushtrues detyre i drejtorit, ai bën një shpallje publike dhe e punëson veten si dentist; si ushtrues detyre i drejtorit publikon shpallje të brendshme dhe fiton specializim, në bazë të të cilit lidh marrëveshje në emër të institucionit me Fakultetin Stomatologjik Shkup për pagesën e tarifës

për specializim; përderisa është drejtor shpesh pushohet nga puna për ndjekjen e specializimit ku thuhet se drejton makinën e kompanisë.

Me qëllim të verifikimit të pretendimeve dhe përcaktimit të plotë të gjendjes faktike në çështjen e hapur, KSHPK-ja iu drejtua Ministrisë së Shëndetësisë me kërkesë në përputhje me kompetencat ligjore për të mbikëqyrur ligjshmërinë e punës së personit të treguar në lidhje me pretendimet e mësipërme. nga raporti dhe të njoftojë KSHPK-në, për të cilën kërkesë nuk është dhënë përgjigje.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja konstatoi se për pretendimet në lëndë janë hapur disa lëndë, disa në njësinë për parandalimin e korrupsionit dhe disa në njësinë për parandalimin e konfliktit të interesit dhe lobimit. Përkatësisht, në lëndën nr. 12-1199/1 nga 19.02.2020, në seancën e 82-të të KSHPK-së, të mbajtur më 14.02.2023, është marrë vendim për ndërprerjen e procedurës. Gjithashtu, sipas lëndës 09-4302/1 të datës 17.12.2020, në seancën e 84-të të KSHPK-së, të mbajtur më 31.02.2023, është marrë vendim për iniciimin e iniciativës për fillimin e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë së personit zyrtarë në Ministrinë e Shëndetësisë.

Duke pasur parasysh të lartpërmendurën, KSHPK-ja përcaktoi se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar:

- Parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: B.K.SH

Miratoi: G.T, anëtar i KSHPK-së

**KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
Nënkryetar,
Katica Nikolovska**